



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 46

Prishtinë, më 02.04.2012, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Goran Marinković, Anton Quni, Fatmir Xhelili, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Mungoi: Rexhep Selimi

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të mbajtura më 16.03.2012 dhe 23.03.2012;
3. Njoftimi i Komisionit për vizitën e Realizuar në Gjermani;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

Duke pasur për bazë ngjarjen e fundit që ka ndodhur me rasti e kidnapimit të dy policëve të Policisë Kufitare të Kosovës, i cili konsiderohet si një akt i shkeljes së sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës, i agresionit mbi territorin do të fillojmë diskutimin për këtë çështje.

Mënyra se si është paraqitur rasti në publik dhe në media në mënyrë vizuale tregon se Serbia nuk po heq dorë nga veprimet anti-Kosovë, si dhe mënyra brutale dhe poshtëruese e sjelljes ndaj Kosovës bënë që Komisioni të ketë vlerësimin e vetë nga të gjithë anëtarët. Por, vlerësoj se veprimet e tilla kanë dëmtuar imazhin e Policisë së Kosovës dhe për këtë arsye ftojme institucionet e Kosovës, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Drejtorin e Policisë që me përgjegjësi më të madhe të ndërmarrin masa në mënyrë që veprime të tilla të mos lejohen në territorin e Republikës së Kosovës.

Është obligim i Policisë së Kosovës të mbroj territorin e Kosovës, qytetarët e saj, vetveten dhe të mos lejojnë që të poshtërohen para veprimeve anti-Kosovë që ndërmerren nga Serbia. Në të njëjtën ditë që janë liruar të burgosurit që kanë qenë me dokumentacion të një shteti tjetër, në të njëjtën ditë ka ndodhur kidnapimi i policëve të Policisë së Kosovës, prandaj Serbia pa asnjë kusht duhet të bëjë lirin e tyre, të kthehen në Kosovë dhe institucionet tona me përgjegjësinë më të lartë ti përgjigjen detyrave të cilat kanë para Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës.

E konsiderojmë dhe cenim të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, e cila ka marrë obligim që të mbroj kufijtë e Kosovës dhe se kjo është sjellja më e keqe e një shteti që ka fituar të drejtën e kandidaturës për në BE, prandaj edhe bashkësia ndërkombëtare në rastin konkret BE, duhet të rishikoj pozicionin e Serbisë pasi me sjellje të tilla antidemokratike që cenojnë vlerat më të larta të një vendi nuk mund të shkohet në Evropë.

Kërkojmë përgjegjësinë më të lartë nga institucionet e shtetit të Kosovës që të mbrohen vlerat demokratike të krijuara në vend.

Fatmir Xhelili- Si Komision kemi qasje serioze ndaj kësaj problematike dhe ndaj veprimit të policisë serbe në vijën kufitare dhe në territorin e Kosovës, kjo e konfirmon atë që politika serbe është një politikë dualiste, edhe pse pretendon të prezantohet si një politikë demokratike ndaj Bashkimit Evropian, ndërsa ndaj Kosovës e vazhdon politikën e vjetër, kjo dëshmon që segmentet e sigurisë të Serbisë nuk janë reformuar dhe as politika e saj si në drejtim të BE-së ashtu edhe në drejtim të Kosovës.

Me një akt të tillë shteti Serb ka dëshmuar që nuk e zbaton asnjë prej marrëveshjeve që kanë me Bashkimin Evropian, relacionet e krijuara në bisedimet e fundit me z. Rober Cooper dhe segmentet e tjera përgjegjëse për rrjedhat e politikës në drejtim të Kosovës dhe marrëveshjeve me Serbinë. Me një veprim të tillë është cenuar integriteti i Kosovës, gjithashtu është lënduar edhe performanca e KFOR-it, pasi KFOR-i ka përgjegjësi për sigurimin e vijës kufitare të Kosovës në drejtim të Serbisë.

Mendoj që kujdesi dhe përkushtimi i Policisë së Kosovës është dashur të jetë më në nivel për arsye se Ministri i Punëve të Brendshme të Serbisë, Ivica Dačić paralajmëroi këto arrestime, dhe me këtë veprim ka luajtur me kartën që të shkakton zhvillime në Kosovë që të jenë në favor të Serbisë. Megjithatë mendoj që politika dhe udhëheqja e Kosovës duhet të jetë e matur në këtë rast, por komponentët e sigurisë dhe Policia të jenë në nivel të detyrës për kryerjen e obligimeve që dalin nga Kushtetuta dhe ligjet për veprimin e tyre. Si anëtar i Komisionit pajtohem me vlerësimet e prezantuara që gatishmëri dhe niveli i përgjegjësisë të segmenteve të sigurisë të rritet, bashkë me institucionet që janë përgjegjëse për të.

Vjollca Krasniqi- Ngjarja e fundit është një veprim i shëmtuar nga ana e Policisë së Serbisë, kjo të bënë të mendosh që bisedimet me Serbinë të ashtuquajtura teknike të bindin që nga këto bisedime vetëm njëra palë të ketë privilegje, në këtë rast Serbia dhe jo marrëveshje të implementueshme për të dy palët.

Flitet për Menaxhim të Integruar të Kufijve, kjo nënkupton që kufijtë të menaxhohen në mënyrë të përbashkët, nga Policia e Kosovës dhe nga ajo e Serbisë. Do të duhej që kjo të funksiononte, e jo të arrestohen policët kufitar. Serbia implementon masa të reciprocitetit vetëm në raste të caktuara. Paralajmërimet e Ministrit të Punëve të Brendshme të Serbisë për masa reciprociteti, pasi kjo ka ndodhur menjëherë pas arrestimit të qytetarëve serb, dhe kjo është bërë në kufirin me Serbinë.

Kërkojmë nga institucionet tona që të bëjnë të pa mundurën, që të dy policët e arrestuar të kthehen në Kosovë pasi nuk e meritojnë të qëndrojnë në burgjet e Serbisë.

Ganimete Musliu- Si anëtare e Komisionit shpreh indinjatën time më të thellë për policët e arrestuar, gjithashtu shpreh keqardhjen time për maltretimet që u bëhen qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilët udhëtojnë nga vendet perëndimore për në Kosovë, rasti konkret nga Gjermania, të cilët keqtrajtohen me orë të tëra në vijat kufitare të Serbisë.

Kërkoj nga organet shtetërore të Republikës së Kosovës që të jenë këmbëngulës në kërkesat tona dhe të jenë të vendosur që dy anëtarët e policisë të kthehen në Kosovë pasi janë të arrestuar pa meritë, gjithashtu mbështes qëndrimet e z. Ahmet Isufi që të dy policët të lirohen sa më shpejtë dhe pa asnjë kusht dhe ti kthehen Kosovës.

Goran Marinković- Duhet të jemi objektiv në vlerësimin e situatës, e dimë se kush është përgjegjës për kufijtë e Kosovës dhe se fjalët e mëdha nuk janë adekuate për tu shqiptuar nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari i Komisionit- Si Komision, do të informohemi nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, për rrjedhën e ngjarjeve por kërcënimet e z. Dačić janë vërtetuar me rastin e veprimit, prandaj mënyra se si ka ndodhur rasti është i dënueshëm pasi një mënyrë e tillë e komunikimit nuk është e tolerueshme, pasi është cenuar territori, uniforma e një shteti nga ana e Serbisë.

Emin Gërbeshi- Serbia edhe njëherë ka bërë agresion mbi territorin e Republikës së Kosovës dhe mendoj që institucionet e Kosovës, Qeveria, Parlamenti, Ministria e Punëve të Brendshme dhe zinxhiri komandues duhet të rishikohet në këtë rast. Qeveria duhet të rishikoj pozicionin karshi Serbisë, duhet të rishikoj edhe pozicionin e bisedimeve me Serbinë që udhëhiqen nga Bashkimi Evropian. Mendoj që Kosova nuk ka asnjë arsye të zhvilloj bisedime me Serbinë, nuk ka arsye të nënshkruaj marrëveshje të cilat Serbia nuk i respekton.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, duhet të ketë pozicion të qartë rreth kësaj çështje, të jap propozime të qarta të cilat duhen të merren seriozisht nga Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës, zinxhiri komandues i Policisë. Me këtë rast u pa që zinxhiri komandues ka defekte, shumë segmente nuk janë në nivel të detyrës, duhet një organizim më profesional pasi kur është në pyetje kufiri shtetëror duhet të kemi shumë kujdes.

Mendoj që as dy policët e arrestuar në territorin e Kosovës, megjithëse se Serbia ka mundur të bëjë këtë, Kosova është dashur ti përgjigjet asht siç një shtet sovran përgjigjet kur ka agresion. Mendimi im për zinxhirin komandues të Policisë është negativ, mendoj që Drejtori i Policisë duhet ta rishikoj pozicionin e vet dhe të mendoj për dorëheqje, për arsye se nuk ka qenë në nivel të detyrës as me deklaratat e dhëna për këtë rast, të njëjtin mendim kam edhe për Ministrin e Punëve të Brendshme i cili nuk ka qenë në nivel të detyrës për rastin në fjalë.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, duhet të dalë me një deklaratë të fuqishme, që të bëjë me dije që Serbia nuk mund të luaj me Kosovën dhe nuk mund të shkel në territorin e Kosovës sa herë të dojë dhe të mbetet pa një përgjigjeje adekuate nga institucionet e Kosovës dhe Kosova. Sa i përket Policisë dhe forcave të tjera, Qeveria e Kosovës duhet të forcoj forcat e veta, ndërsa sa i përket faktorit ndërkombëtar që ka obligime për çështje të Sigurisë, duhet ta dimë që nuk do të jetë gjithmonë në Kosovë dhe se ne vetë duhet ta sigurojmë vetveten.

Kryetari i Komisionit- Pas gjithë kësaj, vlen konstatimi i përbashkët që të kemi një informatë të detajuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe që aktin e dënueshmë në formën që e shprehëm në Komision

2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të mbajtura më 16.03.2012 dhe 23.03.2012

Kryetari i Komisionit- Për shkak që nuk e kemi përkthimin në gjuhën serbe, propozoj që miratimi i tyre të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Anëtarët e Komisionit ranë dakord që miratimi i procesverbaleve të mbetet për mbledhjen e radhës.

3. Njoftimi i Komisionit për vizitën e Realizuar në Gjermani

Kryetari i Komisionit- Më lejoni të ju falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit që keni qenë në këtë vizitë dhe për përgjegjësinë e treguar me rastin e vizitës, me paraqitjet dhe me angazhimin e juaj për shtatë ditë.

Vizita në Gjermani ishte shumë e mirë, për shkak se edhe në planin diplomatik në takimet që i kemi pasur, ka qenë një vlerësim shumë pozitiv për Kosovën, për zhvillimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës si dhe për angazhimet tona në të ardhmen nga përvojat e marra për kontrollin demokratik të institucioneve të sigurisë në Kosovë.

Takimi në Hamelburg, stërvitjet e drejtpërdrejta që kemi parë, takimet zyrtare që kemi pasur në nivel Ministri, Kryetares së Komisionit të Mbrojtjes, Bundestagut, Bundesver takimet me Gjeneralët gjerman, të cilët ishin njohës të mirë të rrethanave në Kosovë, në Akademi dhe Institute nga të cilat kemi marrë vlerësime të mira dhe një qasje shumë pozitive ndaj Kosovës deri në përfundimin e vizitës në Muzeun Ushtarak, Historik të Dresdenit. Përvojat e marra do të na duhen në të ardhmen, në mënyrë që të kemi një angazhim të drejtpërdrejtë në implementimin e politikave pozitive të monitorimit dhe kontrollit demokratik të institucioneve të sigurisë në Kosovë.

Falënderim të veçantë për Ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, z. Teichel dhe z. Nebelung, përfaqësues i GIZ-it në Kosovë, ish- Komisioneri Robbe, dhe konsideroj që vizita ka qenë shumë e suksesshme.

Fatmir Xhelili- Konsideroj që përvojat e fituara nga vizita në Gjermani janë shumë domethënëse, në mënyrë që në institucionet tona të implementojmë format dhe mënyrat e mbikëqyrjes së segmenteve të cilat kemi kompetencë që ti mbikëqyrim, posaçërisht FSK-në. Vlerësoj që niveli i takimeve dhe qasjeve ndaj problematikave për të cilat kemi qenë të interesuar, përvojat e ofruara janë ndikuese në konceptet, mënyrën e mendimit dhe të realizimit të metodologjive në të ardhmen për mbikëqyrjen e strukturave të sigurisë.

Shpresoj që Komisioni të ketë iniciativë për krijimin e mekanizmave të tillë mbikëqyrës, në mënyrë që pjesëtarët e Forcës së Sigurisë, pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës të kenë mekanizëm shtesë që do të jetë adresë e caktuar për adresimin e ankesave apo fenomeneve negative gjatë ushtrimit të detyrës së tyre.

Kryetari i Komisionit- Vlerësim i përbashkët është që vizita në Gjermani ja ka vlejtur, nga përvojat e marra mund të zbatohet në praktikë mënyrën e kontrollit demokratik të institucioneve të sigurisë.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Në këtë pikë kam dy njoftime. Njëra rreth vizitës së delegacionit Hungarez në Kosovë, e cila do të jetë me 4 dhe 5 prill 2012. Vizita e këtij delegacioni do të jetë në Ministrinë e FSK-së dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe takim me Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Nga Ministria e FSK-së, kemi kërkesë që nga Komisioni të jenë të pranishëm tre anëtarë, ku përveç Kryetarit të Komisionit, kërkoj që të propozoni dhe dy anëtarë të tjerë. Anëtarët propozuan që z. Fatmir Xhelili dhe z. Anton Quni të jenë në takimin e delegacionit hungarez dhe Ministrit të FSK-së.

Njoftimi tjetër ka të bëjë me një vizitë studimore e organizuar nga DCAF-i nga 7 deri 11 maj 2012 në Ljublanë në të cilën është e ftuar Komisioni për AKI, por nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, janë të ftuar dy anëtarë. Këtë çështje po e hedh në diskutim, se kush mendon që duhet të shkoj nga Komisioni.

Anëtarët propozuan që pjesëmarrës në këtë vizitë studimore të jenë, Kryetari i Komisionit, z. Ahmet Isufi dhe z. Anton Quni, anëtar i Komisionit.

Me këtë pikë të rendit të ditës, Kryetari e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi